



PËRMES TAKIMEVE ME GRATË SIPËRMARRËSE, DERI TE BASHKËPUNIMI MË I MADH I DAP ME OBLIGUESIT TATIMORË

Drejtoresha e Drejtorisë së të Ardhurave Publike Sanja Llukarevska sot në Kumanovë u takua me gratë sipërmarrëse, menaxhere dhe kontabiliste nga pjesa verilindore e vendit.

Në takim pjesëmarrëset e përshëndetën angazhimin e Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe para se gjithash drejtoreshën Llukarevska, të dëgjohen përvojat dhe sfidat me të cilat çdo ditë takohen gratë sipërmarrëse gjatë udhëheqjes së bizneseve të tyre. Të pranishmit theksuan se çdo ditë investojnë në avansimin e pozitave të gruas në bashkësinë e biznesit dhe përmes veprimtarive të tyre në kontinuitet tregojnë se janë segment i rëndësishëm në ekonomi.

Takimet e këtilla siç sqaruan, janë të mirëseardhura, sepse ndihmojnë në tejkalimin dhe zgjidhjen e të gjitha qështjeve të hapura dhe dilemat dhe mundësojnë të dëgjohet zëri i obliguesit tatimor me qëllim krijimin e kushteve të drejta për të gjitha palët e interesuar në ekonominë vendore.

